ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**622-24-5284-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Zhvillimi i gjeodatabazës dhe sistemit Web GIS për Drejtorinë e shërbimeve publike në Komunën e Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Consult Engineering sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Shaqir Kuka, pn,
(Adresa)

Kaçanik *(Vendi)*

71000 *(Kodi postar)*

044431224 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Jakup Kuka
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@consult-eng.com
(Adresa elektronike)

21/11/2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR CONSULT ENGINEERING

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datë 27.05.2024
Njoftimi i fundit për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 11.11.2024
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 22.11.2024
Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☑

Data e fundit për dorëzim të tenderëve është 22.11.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☑ **Jo** ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 08.11.2024 kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK në këtë aktivitet të prokurimit publik ka shkelur LPP, neni 1, neni 4.1.37, neni 7, dhe RRPP neni 4 AK me date 11.11.2024 ka publikuar njoftimin mbi refuzimn e kërkesës per rishqyrtim, duke mos konsideruar aspak pretendimet ankimore, përveç tjerash ne ndërlidhje me vendimin e OSHP nr. 2024/0874 te dt. 18.10.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e pretenduara sipas LPP ✓ Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar) ✓ Neni 1, paragrafi 1; ✓ Neni 4.1.37; ✓ Neni 7, paragrafi 2, 4 dhe 5; ✓ Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 4, paragrafi 4.3.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Për këtë aktivitet të prokurimit ne si OE **kemi dorëzuar Ankesë ne OSHP me date 27.06.2024**, ku vendimi i OSHP nr. 2024/0557 i datës 12.08.2024 ka aprovuar në tërësi ankesën tonë.

- ESH ka aprovuar në tërësi pretendimet ankimore, dhe vendimi i OSHP konfirmon pajtimi e palëve, ku AK pajtohet me mendimin e ESH.
- Mirëpo, përkundër faktit se vendimi i OSHP ka obliguar AK të bëjë përmirësimin e kërkesave teknike dhe profesionale në përputhje me LPP duke larguar çdo kriter diskriminues, AK me datë 30.08.2024 publikon njoftimin për korrigjim dhe dokumentacionin e dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit publik, ku AK vendos përsëri dhe në mënyrë edhe me të theksuar kërkesa në kundërshtim me LPP.
- AK ka vendosur në lajthitje PSH të OSHP sepse është pajtuar me mendimin e ESH dhe nuk ka ndryshuar kërkesat e dosjes së tenderit në përputhje me të.

II. **Me datë 19.09.2024 përsëri kemi dorëzuar Ankesë në OSHP**, dhe PSH së bashku me ESH me vendimin nr. 2024/0874 e datës 18.10.2024 pranojnë pretendimet tona ankimore dhe ankesën si të bazuar.

- Vendimi i OSHP thekson pajtimin e palëve, ku AK pajtohet me mendimin e ESH i cili aprovon në tërësi pretendimet ankimore, **mirëpo për të dytën herë radhazi AK vendos në lajthitje OSHP** sepse në njoftimin per korrigjim të datës 11.11.2024 **vendos kritere të njëjta diskriminuese, në kundërshtim me LPP, dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP, me të cilin vetë është pajtuar**.

III. Kjo është ankesa e tretë që ne jemi të detyruar të dorëzojmë në OSHP për këtë tender. Andaj me mirëkuptim kërkojmë nga PSH dhe ESH të shqyrtojnë pretendimet tona ankimore duke i vlerësuar si të bazuara dhe përfundimisht të anulojnë këtë procedurë të prokurimit publik.

<u>Pretendim ankimor 1.</u>

Ndaj pretendimit tonë ankimor në ankesën paraprake se AK po kërkon produkte duke specifikuar emrin e prodhuesit, Eksperti shqyrtues si pjesë e vendimin të OSHP nr 2024/0557 i datës 12.08.2024 sqaron:

> Këtu është cekur emri specifik i softuerit ***"ArcGIS softuer"***, andaj përveç ndryshimit përmes njoftimit për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, kërkesa për autorizimin nga prodhuesi i ***"ArcGIS"*** u pamundëson (përjashton nga gara) aplikimin shumë kompanive të cilat mund të ofrojnë zgjidhje me kod të hapur "***Open Source***" dhe me aplikacione tjera. Rrjedhimisht, është kriter diskriminues dhe ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e konkurrencës, ekonomicitetit dhe efikasitetit, andaj propozoj që **pretendimi ankimor 3** të aprovohet **si i bazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së dhe AK me rast te ritenderimit ta mbajë kërkesën per autorizim të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, por i njejti të jetë në emër dhe me titull të platformës së ofertuar nga OE përkatës.

Në vazhdim, në ndërlidhje me ankesën tonë paraprake, përfshirë të gjitha pretendimet tona ankimore, vendimi final i OSHP nr 2024/0557 i datës 12.08.2024 thekson:

Vendim

1. Aprovohet pajtimi i palëve, për ankesën e OE "Consult Engineering"SH.P.K., me nr. 2024/0557, e datës 27.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i gjeodatabazes dhe sistemit Web GIS për Drejtorinë e shërbimeve publike në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: "622-24-5284-2-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Situatë e njëjtë përsëritet edhe në ankesën tonë të dt. 15.10.2024\ ku ESH aprovon pretendimin ankimor nr.1 ku thotë:

Pergjigja në pretendmet ankimore 1 dhe 2

Eksperti teknik e ka shkarkuar dosjen e re te publikuar me 30.08.2024 dhe përshkrimin e çmimeve të publikuar nga AK në po këtë datë dhe pas krahasimeve të bëra të dosjes së vjetër, ekspertizës së aprovuar dhe dosjes se re të publikuar me *"ndryshimet e sygjeruara"*, konstaton se sa i përket pozicionëve të kërkuara në përshkrimin e çmimeve si në vijim:

11	Përditesimi i ArcGIS Desktop v.10 Standard Përdorimi i njëkohshëm (3 licenca) në versionin më të fundit të disponueshëm komercial të ArcGIS Desktop	total	1
12	ArcGIS Enterprise Standard	total	1

Përseri specifikohet emri i prodhuesit, edhe pse sipas ekspertizes me të cilën është pajtuar AK është dashur qe të perkujdeset mos të ketë emertime të produkteve specifike siç janë: **"ArcGIS"** dhe "**ArcGIS enterprise standard**", e aq më pak kur sipas titullit të projektit kërkohet *"Zhvillim i gjeodatabazës dhe sistemit Web GIS"*, dhe kjo të ben të kuptosh që në këtë rast nuk është e nevojshme përdorimi i aplikacionëve Desktop komercial, spse do të zhvillohet platformë Web e pavarur nga softuerët komercial dhe siç e kam cekur edhe në ekspertizën paraprake mund të shkarkohen dhe përdorën softuerë ***Open Source*** pa permendur emra të cilat mundësojnë plotësimin e kërkesave minimale teknike duke dhenë rezultatet e pritura nga AK, dhe ne të njejtën kohë duke e kursyer buxhetin për blerje të aplikacionëve komerciale, në këtë rast të panevojshme.

Dhe përsëri vendimi i OSHP konfirmon se AK është pajtuar me mendimin e ESH, dhe përkundër kësaj AK vepron në kundërshtim me këtë vendim, ku në njoftimin për korrigjim të shpallur me dt. 11.11.2024 vazhdon në mënyrë të njëjtë të vendos kritere diskriminuese, duke shpërfillur në tërësi vendimin e OSHP.

Pra, qartë thuhet se AK është pajtuar me mendimin e Ekspertit Shqyrtues, dhe përkundër kësaj AK me datë 30.08.2024, gjegjësisht 09.09.2024 shpallë kërkesat të cilat hapur janë në kundërshtim me këtë vendim, siç është kërkesa e paraqitur në paramasë produkti nr. 11 dhe nr 12:

Përditësimi i ArcGIS Desktop v.10 Standard Përdorimi i njëkohshëm (3 licenca) në versionin më të fundit të disponueshëm komercial të ArcGIS Desktop

ArcGIS Enterprise Standard

Gjithashtu në ndërlidhje me këtë është kërkesa në vijim:

Kërkesa 4 Autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i zgjidhjes GIS për

territorin e Kosovës.

Shihet fare qartë se AK për këtë aktivitet të prokurimit po vazhdon me qasje diskriminuese, gjegjësisht favorizuese për një OE të caktuar (në këtë rast ESRI / GDI DOOEL Skopje).

Kërkesa konkrete duke përmendur emrat e prodhuesve, dhe duke mos lënë asnjë alternativë tjetër ekuivalente as komerciale, aq me pak Open Source, në mënyrë të hapur përbën shkelje të LPP, neni 7, paragrafi 2 sepse nuk lejon konkurrencë të hapur ndërmjet OE potencial që ofrojnë shërbime nga fusha e zhvillimit të Web GIS, citojmë:

Neni 7, paragrafi 2:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Kjo në mënyrë të hapur paraqet shkelje të parimeve bazë të prokurimit publik, gjegjësisht nenit 1.1, sepse nuk garanton shfrytëzim të drejtë të fondeve publike, si dhe të RRPP neni 4.3. Po ashtu Ligji i Prokurimit Publik, neni 7.2, 7.4 dhe 7.5 në mënyrë të saktë ndalon që në procedura të hapura të prokurimit të specifikohen me emër të përveçëm produkte ose të ngjashëm që i përkasin vetëm një kompania apo biznesi.

Po ashtu është shkelur RRPP nr. 001/2022, neni 4, paragrafi 4,3 citojmë:
c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorin Ekonomik ose Operatorin Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Pretendim ankimor 2.

Duke kufizuar vetëm produktin ArcGIS të ESRI, në mënyrë të qartë AK favorizon këtë prodhues, gjegjësisht distributorin e autorizuar. Ashtu siç kemi theksuar në ankesat e mëparshme, dhe qartë ESH ka konstatuar të njëjtën se blerja e softuerit desktop ArcGIS me këtë procedure prokurimi është shpenzim i panevojshëm i buxhetit, sepse projekti titullohet Zhvillimi i gjeodatabazës dhe sistemit Web GIS, dhe në këtë rast nuk është aspak e nevojshme përdorimi i softuerëve komercial desktop, sepse platforma Web GIS e cila do të zhvillohet do të jetë krejtësisht e pavarur nga këta softuer. Ose softuerët të ngjashëm desktop me ArcGIS fare thjesht mund të shkarkohen falas pa asnjë pagesë, të cilët janë open source siç është QGIS, i cili mundëson të realizoj 100% funksionet e njëjta që kërkohen në specifikimet teknike. Dy vendimet e mëparshme të OSHP (nr. 024/0557 dhe nr 2024/0874) për këtë tender, shumë qartë kërkojnë që të mundësohen platformat e lira open source, por AK si duket për qëllime tjera, aspak në funksion të realizimit të kontratës, në çdo mënyrë kufizon vetëm produkte softuerike ArcGIS - ESRI.

Në mënyrë të hapur dhe duke shkelur LPP, dhe dy vendime të OSHP, AK favorizon OE të caktuar, duke ndikuar në shfrytëzim jo të drejt të fondeve publike. Kjo po ashtu është në kundërshtim me parimin bazë të LPP, gjegjësisht nenin 1.1, i cili thotë (citojmë):

Neni 1, paragrafi 1:
Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat

që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Arsyetimi i AK se kinse autorizuesi për shitje do të ofrojë të drejtën të interesuarve për distribuim është njësoj kundërligjor (LPP, neni 7.5), sepse OE të interesuar për projektin janë të detyruar që vetëm nga një furnizues - OE të ofrojnë produktin përkatës.

Neni 7, paragrafi 5:

Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

Kërkesa konkrete duke përmendur emrat e teknologjive specifike, dhe duke mos lënë asnjë alternativë tjetër ekuivalente as komerciale, aq më pak Open Source, në mënyrë të hapur përbën shkelje të LPP, neni 7, paragrafi 2 sepse nuk lejon konkurrencë të hapur ndërmjet OE potencial që ofrojnë shërbime nga fusha e zhvillimit të Web GIS, citojmë:

Neni 7, paragrafi 2:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Andaj, kërkojmë nga ju si AK të përmirësoni kërkesën në fjalë duke larguar në tërësi të gjitha kërkesat për kualifikimin dhe kërkesat për certifikatat për pozitën e Menaxherit të Projektit, të cilat janë në kundërshtim me LPP dhe RRPP, nenet respektive siç janë potencuar më lartë, dhe të vendosni vetëm kërkesa në përputhje me LPP dhe RRPP.

Pretendim ankimor 3.

Tek **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1&9.2** i dosjes së tenderit për Kërkesën 1, pozita Menaxher i Projektit është kërkuar:

- Menaxheri i Projektit është përgjegjës për planifikimin, ekzekutimin dhe finalizimin e projektit GIS sipas afateve strikte dhe brenda buxhetit. Kjo përfshin marrjen e burimeve, koordinimin e përpjekjeve të anëtarëve të ekipit dhe menaxhimin e komunikimit me palët e interesuara për të siguruar shpërndarjen e suksesshme të projektit duke plotësuar kriteret si më poshtë 1. OE duhet të caktoj me vendim një menaxher projekti. 2. Menaxheri i projektit duhet të jetë me titull Master i diplomuar i shkencave Kompjuterike, Gjeografi, Gjeodezisë ose Master i Shkencave në Sisteme

të Informacionit, Ndertimtari, Arkitektur ose ejuivalente. 3. Minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. **4. Certifikat në Geo-databas Ms SQL-Server, GIS, Spatial Data Science, GIS and BIM, Data - Menaxhment.**

Ndërsa, pikërisht për këtë pozitë, ESH dhe vendimi i OSHP konfirmojnë se duhet larguar kërkesa diskriminuese për këtë pozitë, certifikata të pa nevojshme, dhe duhet kërkuar si në vijim:

Andaj, propozojmë që AK për pozitën e menaxherit të projektit duhet të kërkojë si më poshtë:

Menaxheri i projektit duhet të jetë me titull: Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes; ose Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike ose; Master i gjeodezisë; ose tituj ekuivalent nga institucione te akredituara vendore dhe te huaja.

Minimum pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit;

Çertifikuar me: ITIL, ose PMP ose Prince 2 ose çertifikim ekuivalent në menaxhim të projekteve;

CV me projekte të realizuara të natyrës së projektit;

Referenca nga punëdhenësit për projektet e realizuara të natyrës së ngjajshme.

Pa përmendur certifikime siç janë tani, sepse menaxheri i projektit në kushte normale ka përshkrim te detyrave dhe obligimeve të cilat jo doemos kanë te bejnë me zhvillim e kodim të aplikacionëve, siç keni kërkuar në FDT. Punët specifike do të kryhen nga stafi i dedikuar për projekt, staf për të cilin keni prezantuar kërkesa të mjaftueshme dhe për të cilat nuk ka pretendime ankimore, andaj pjesa e menaxhimit të projektit nga ana e OE le të mbetet në dorën e projekt menaxherit, për pervojen e të njejtit, për mendimin tim mjaftojnë kërkesat mbi përvojen profesionale dhe deshmitë mbi kualifikimet e arritura të cekura me lartë.

AK përsëri nuk ka përfillur aspak vendimin e OSHP ku edhe pse qartë ky vendim specifikon kërkesat e nevojshme për këtë pozitë, AK vendos kërkesa për certifikata që janë diskriminuese sepse nuk kanë të bëjnë aspak me këtë pozitë.

Gjithashtu edhe për pozitat tjera për staf në kuadër të kërkesës 1, vendos kritere diskriminuese, si psh për pozitën Arkitekt i sistemit, kërkohen gjithsej 3 certifikata, njëra për organizim teknik të projekteve nga ITIL ose tjera, e dyta për baza të të dhënave, dhe e treta për zhvillim softuerik. Nga kjo del se personi për këtë pozitë nuk është vetëm arkitekt softuerik por edhe organizues teknik, edhe zhvillues i databazës, edhe zhvillues softuerik. Qartë AK vendos kritere që nuk kanë të bëjnë aspak me pozitën në fjalë, por vetëm sa për te kërkuar me shumë certifikata për të ulur konkurrencën e lire, duke favorizuar OE të caktura. *Shiko në vijim kërkesat për Arkitekt softuerik:*

Çertifikime 3.1. I certifikuar nga institucioni i autorizuar si ITIL – Information Technology Infrastructure Library nga Axelos ose Prince2 - PRojects IN Controlled Environments nga Axelos ose Professional Scrum Master - nga scrum.org ose çdo çertifikim tjetër ekuivalent që dëshmon njohuritë në organizim Teknik të projekteve të lëshuar nga ndonjë ofrues i njohur botëror certifikues 3.2.I çerifikuar në baza të të dhënave me ndonje certifikim në Microsoft SQL Server ose Oracle DBA Certified ose çdo çertifikim tjetër ekuivalent që dëshmon njohuritë e avancuara të bazave të të dhënave nga ndonjë ofrues i njohur botëror certifikues 3.3.I çerifikuar në zhvillim softuerik me

ndonjë certifikim sipas kornizave aktuale të zhvillimit softuerik të përcaktuara nga Agjencia e Shoqërisë sëinformacionit në Microsoft .NET Framework ose Microsoft .NET Core ose Spring Framework ose Node.JS ose çdo çertifikim tjetër ekuivalent që dëshmon njohuritë e avancuara të zhvillimit softuerik të aplikacioneve nga ndonjë ofrues i njohur botëror certifikues.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë të gjitha pretendimet tona ankimore, ndërsa për referencë ju lutem merrni në konsideratë dy vendimet e juaja paraprake. Bazuar në deklarimet si më lartë, në argumentet e pakontestueshme që kemi ofruar, si dhe duke qene se AK për dy herë me radhe vendos në lajthitje OSHP, duke u pajtuar me mendimin e ESH, pastaj duke vepruar në kudnershtim me atë mendim dhe vendim të OSHP, kërkojmë nga OSHP, si dhe në mbështetje të plotë në LPP-në dhe legjislacionin sekondar, të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE "Consult Engineering" SH.P.K.

II. **ANULOHET** ky aktivitet i prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se si rezultat i shkeljeve ligjore si më sipër, dëmet materiale të shkaktuara janë rreth 75,000 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
c) një kopje e njoftimit për vendimin e AK.
d) një kopje e kërkesës për rishqyrtim
e) një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*